



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:223295

Datë: 19.04.2024

Numri i dokumentit: 05597859

C.nr. 3241/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me bashkëpunëtorin profesional L.K. duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit S.M. me numër personal nga fshati Pllanjanë, komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. V.O. nga Prizreni, kundër të paditurit A.M. me numër personal nga fshati Pllanjanë, komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. E.G. nga Prizreni, me objekt kontesti pengim posedimi, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor-publik, në prezencë të paditësit dhe të paditurit si dhe të autorizuarit të tij, me datën 05.04.2024, mori dhe me datë 19.04.2024, përpiloi me shkrim këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit S.M. nga fshati Pllanjanë, Komuna e Prizrenit, me të cilën ka kërkuar që të *“Aprovohet kërkesëpadia e paditësit S.M. nga fshati Planjan, Komuna e Prizrenit ashtu që Vërtetohet se i padituri A.M. nga fshati Pllanjanë Komuna e Prizrenit, me datë 30.09.2021 i ka penguar në posedim dhe shfrytëzimin e lirë paditësin, objektin i cili është ndërtuar në njësinë kadastrale 02349-0, i cili objekt ka qenë në shfrytëzim të paditësit bazuar në ndarjen e pasurisë së përbashkët të trashëguar, ashtu që i njëjti në këtë objekt pa lejen paraprake të poseduesit të saj, angazhon punëtorët e KEDS dhe në këtë objekt vendos njehsorin elektrik në murin e jashtëm të saj, duke penguar në posedim paditësin në posedimin e lirë të kësaj paluajtshmërie dhe të Obligohet i padituri A.M. që menjëherë të heq njehsorin elektrik të vendosur në murin e objektit të lartë cekur dhe në të ardhmen të mos ndërmerr asnjë veprim nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm” e pabazuar.*
- II. DETYROHET** paditësi S.M. që në emër të shpenzimeve procedurale t’ia paguaj të paditurit A.M. shumën në lartësi prej 890.00 euro, dhe atë brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi S.M. nga fshati Pllanjanë, Komuna e Prizrenit, me datë 06.10.2021, ka parashtruar padi për pengim përkatësisht shqetësim në bashkëpronësi (actio negatoria) me propozim të caktimit të masës së përkohshme të sigurimit ndaj të paditurit A.M. nga fshati

Pllanjanë, Komuna e Prizrenit, ndërsa me parashtresën e datë 20.11.2023, ka bërë plotësimin e padisë me të cilën ka kërkuar që të aprovet kërkesëpadia e paditësit dhe të vërtetohet se i padituri A.M. nga fshati Pllanjanë Komuna e Prizrenit, me datë 30.09.2021, i ka penguar në posedim dhe shfrytëzimin e lirë paditësin S.M. në objektin i cili është ndërtuar në njësinë kadastrale 02349-0, i cili objekt ka qenë në shfrytëzim të paditësit bazuar në ndarjen e pasurisë së përbashkët të trashëguar, ashtu që i njëjti në këtë objekt pa lejen paraprake të poseduesit të saj, angazhon punëtorët e KEDS-it, dhe në këtë objekt vendos njehsorin elektrik në murin e jashtëm të saj, duke penguar në posedim paditësin në posedimin e lirë të kësaj paluajtshmërie dhe ka kërkuar që të obligohet i padituri A.M. që menjëherë të heq njehsorin elektrik të vendosur në murin e objektit të lartë cekur dhe në të ardhmen të mos ndërmerr asnjë veprim nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Edhe gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë të precizuar, ka shtuar se me administrimin e provave në këtë çështje kontestimore të cilat i janë bashkangjitur padisë është vërtetuar se i padituri ka penguar posedimin e fundit faktik të paditësit, andaj nisur nga kjo i ka propozuar gjykatës që të aprovojë kërkesëpadinë e paditësit sipas parashtresës për precizimin e datës 20.11.2023, duke e obliguar të paditurin që ta heqë njehsorin elektrik si dhe ti mbulojë shpenzimet e procedurës kontestimore sipas tarifës së OAK-së të specifikuar në fjalën përfundimtare.

I autorizuari i të paditurit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjegjës në padi dhe deklarimeve në shqyrtimet e mbajtura, me të cilën e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetim se i padituri jeton dhe vepron jashtë shtetit të Kosovës, dhe se kjo padi nuk ka asnjë bazë ligjore dhe as fakte se të njëjtin e ka penguar apo shqetësuar në pronën e tij, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pabazuar për shkak të legjitimitetit por edhe për shkak se nuk kemi të bëjmë me objekt të padisë ngase njehsori elektrik është vendosur nga punëtorët e KEDS-it, në objektin i cili në certifikatën e pronësisë fare nuk ekziston si objekt, prona është e përbashkët mes vëllezërve dhe motrave, ndërsa në posedim faktik e ka këtu i padituri, i cili prej disa viteve deri sa ka qenë i ati T.M. gjallë, i ka ndarë fëmijët dhe pronën në mes vete, mirëpo për shkak të raporteve jo të mira mes palëve ndërgjyqëse akoma nuk është bërë ndarja fizike dhe nuk është bërë bartja e të drejtës së pronësisë. Edhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se ngelet pranë pretendimeve nga shqyrtimet e mëhershme duke shtuar se njehsorin elektrik e kanë vendosur zyrtaret e KEDS-it, me kërkesën e të paditurit A.M. që të hiqet njehsori nga shtëpia dhe të vendoset në vend të përshtatshëm për KEDS-in, për ta lexuar jashtë oborrit pasi që i njëjti nuk gjendet në Kosovë dhe dyert nuk janë të hapura për të bërë leximin e njehsorit-orës. Në fund ka propozuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar për shkak se i mungon legjitimiteti aktiv dhe të gjitha provat që janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor e vërtetojnë një gjë të tillë. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar në shumën prej 890 euro dhe të njëjtat i ka specifikuar në fjalën përfundimtare.

Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, si dhe duke vepruar sipas vërejtjeve të Gjykatës së Apelit me aktvendimin Ac.nr.5256/2023 të datës 03.10.2023 gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave:

Dëgjimi i dëshmitarit B.M. nga fshati Pllanjanë, Komuna e Prizrenit; Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren CT.nr.4/18 i datës 21.02.2020; Foto e cila në shkresat e lëndës mbanë numrin 9; Kopja e planit e datës 28.02.2014; dëgjimin e paditësit S.M. në cilësi të palës dhe të paditurit A.M. në cilësi të palës; Fatura e tatimit në pronë numri i faturës 3354553312 e datës 05.01.2021; Certifikata me nr.07-029-737-20 për ngastrën kadastrale P-71813066-02349-0, e cila evidentohet në emër të T. (M) M. Seti i fotografive prej tre sosh; Certifikata me numër 07-463-04-70202-23 e datës 25.05.2023 njësia kadastrale P-71813066-02349-0 ZK Pllanjanë; Dëgjimi i dëshmitarit Š.M. nga fshati Pllanjanë, Komuna e Prizrenit; Dëgjimi i dëshmitares Z.S. nga fshati Pllanjanë, Komuna e Prizrenit; Parashtrësia së dorëzuar nga KEDS, pranuar në gjykatë me datën 21.02.2024, së bashku me procesverbalin nr.2177335 të datës 02.10.2021, kërkesa për lidhje të re nga aplikuesi A.M. e datës 16.11.2021, procesverbali me numër 0784856 e datës 17.11.2021, si dhe procesverbali për praninë të instalimit elektrik nr.0079511 të datës 02.12.2021.

Gjykata pas vlerësimit të deklaramëve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të tjera, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ku ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor ka bërë edhe dëgjimin e dëshmitarit, B.M. i cili ka deklaruar se një natë duke kaluar rrugën në të cilën gjendet objekti i cili është objekt i këtij kontesti ka vërejtur se diçka po punohet në murin e objektit-shtallës, ku ka takuar një elektrikist me emrin e quajtur R. nga i cili kam kërkuar që mundësisht të më ndihmoj edhe atij lidhur me disa punë elektrike e i cili i ka thënë se është i zënë por nesër mund të vij tek ti, ndërsa të nesërmen ka parë se në murin e shtallës ishte vendosur një orman i rrymës elektrike”.

Nga fotoja e pa datuar e cila gjendet në shkresat e lëndës që mbanë numrin 9, e formatit A4, në versionin bardh e zi (pa ngjyra), vërehen disa objekte gjegjësisht dy shtëpi banimi dhe objekti – shtalla;

Nga leximi i kopjes së planit të datës 28.02.2014, lëshuar nga Kuvendi Komunal-Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Prizren, gjykata vërtetoi se parcela me nr. të ngastrës 2349-0, evidentohet në pronësi të T. (M) M. e cila gjendet në fshatin Pllanjanë, Komuna e Prizrenit, me kulturë livadh, klasa e 5, në vendin e quajtur ”Kopaq - Brest” me sip. 41.79 m² dhe një shtëpi me sip. prej 84 m².

Nga leximi i faturës së tatimit në pronë me numri të faturës 3354553312 e datës 05.01.2021, gjykata vërtetoi faktin se fatura e tatimit në pronë evidentohet në emër të Tefik Muratit nga fshati Pllanjanë, Komuna e Prizrenit.

Nga leximi i aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren me numër të dosjes CT.nr.4/18 të datës 21.02.2020, gjykata ka konstatuar se këtu palët ndërgjyqëse dhe pasardhësit e tjerë të tani të ndjerit T.M. ish nga fshati Pllanjanë, Komuna e Prizrenit, janë shpallur

trashëgimtarë dhe këtu ndërgjyqësit kanë trashëguar në 5/35 pjesë ideale në tërë pasurin e paluajtshme të lënë nga ana e trashëgimlënësit, e ku bënë pjesë edhe njësia kadastrale 2349 ZK Pllanjanë.

Nga leximi i certifikatës me nr. 07-029-737-20 e datës 25.01.2021 dhe certifikatës me nr. 07-463-04-70202-23 e datës 25.05.2023, për ngastrën kadastrale P-71813066-02349-0, gjykata ka konstatuar se njësia kadastrale P-71813066-02349-0 ZK Pllanjanë evidentohet në emër të T. (M) M.

Gjykata nga seti i fotografive të pa datuara prej tre sosh, të formatit A4, në versionin me ngjyra, të cilat në shkresa të lëndës mbajnë numrat 68, 69 dhe 70, vërehet objekti - shtalla, e cila është e ndërtuar nga materiale të forta prej betoni dhe bllokave të betonit, në të cilën në pjesën e jashtme nga rruga janë vendosur dy kuti në njërin prej tyre është shenja e rrymës për të cilat ndërgjyqësit deklarojnë se janë ormanët e orës elektrike.

Gjykata po ashtu ka bërë edhe dëgjimin e dëshmitarit Š.M. nga fshati Pllanjanë, Komuna e Prizrenit, i cili ka deklaruar se, palët ndërgjyqëse janë vëllezërit e tij, dhe se objekti-shtalla shfrytëzohet nga palët ndërgjyqëse, por më shumë e ka shfrytëzuar paditësi S.M. deri sa ka qenë gjallë babai shtalla më ka takuar mua dhe të paditurit A.M. ndërsa që një kohë të gjatë është duke e shfrytëzuar edhe paditësi S.M. e shfrytëson katin epërm ndërsa A.M. e shfrytëzon katin përdhese. Ndërsa sa i përket vendosjes së ormanit dhe njehsorin elektrik nuk e din kur është vendosur pasi ka qenë jashtë shtetit, mirëpo sipas dijenisë së tij ky orman është vendosur për të paditurin A.M. në pjesën e rrugës në katin e epërm.

Gjykata po ashtu ka bërë edhe dëgjimin dëshmitares Z.S. nga fshati Pllanjanë, Komuna e Prizrenit, e cila ka deklaruar se i gjithë objekti i takon A.M. pasi që ia ka lënë baba, mirëpo A. shtallën ia ka lejuar në shfrytëzim vëllaut të tij S. ka shtuar se shtalla i ka dy kate, përdhesen dhe katin e parë, përdhesen e shfrytëzon A. ndërsa katin e parë e shfrytëzon S. njehsori është vendosur në katin e parë kah pjesa e rrugës.

Nga leximi i parashtrësës së dorëzuar nga KEDS, pranuar në gjykatë me datën 21.02.2024, së bashku me procesverbalin nr.2177335 të datës 02.10.2021, nga kërkesa për lidhje të re nga aplikuesi A.M. e datës 16.11.2021, nga procesverbali me numër 0784856 e datës 17.11.2021, si dhe nga procesverbali për pranim të instalimit elektrik nr.0079511 të datës 02.12.2021, gjykata vërtetoi faktin se me datë 15.08.2021 punëtorët e autorizuar të kompanisë kanë qenë të konsumatori A.M. dhe kanë konstatuar se të njëjtit duhet ti vendoset një njehsor elektrik dhe të regjistrohet si shfrytëzues energjisë elektrike, dhe pas verifikimit të gjendjes në teren është përpiluar procesverbal me të cilin është konstatuar se A.M. nuk posedon kablllo furnizuese andaj dhe nuk mund të bëhet lidhja e re, ndërsa me datë 16.11.2021, konsumatori A.M. ka paraqitur kërkesë për lidhje të re, ndërsa me datë 02.12.2021, është bërë pranimi i instalimit elektrik me kyçje ajrore 4 x 25 në ormanin jashtë murit.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor ka bërë edhe dëgjimin e paditësit, S.M. në cilësi të palës i cili ka deklaruar se prona në të cilin është vendosur ormani elektrik është objekt kontesti civil, dhe deri në zgjidhjen e çështjes në fjalë, i ka propozuar që të mos vendoset

ormani i cili është objekt kontesti në këtë çështje, mirëpo i njëjti me vetë iniciativ pa konsultim paraprak ka vendosur ormain elektrik në murin e shtallës, pasi që ormani elektrik nuk mund të vendoset në objekte private por të njëjtin duhet të vendoset në shtylla elektrike –publike, ndërsa në pyetjen kush e ka vendosur ormanin elektrik në murin e shtallës i njëjti ka deklaruar se KEK-u e ka vendosur ormain elektrik.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor ka bërë edhe dëgjimin e paditurit, A.M. në cilësi të palës i cili ka deklaruar se jeton jashtë shtetit dhe se prona tij është e rrethuar dhe askush nuk mund të hyj brenda. Keds e ka ftuar dhe pyetur se a mund ta vendosim njëisorin e rrymës. Paditësi ka shkaktuar probleme pasi që prindi na ka ndarë mirëpo por ende nuk jemi ndarë nga gjykata. Në objektin ku është i vendosur njëSORI e paguan tatimin.

Baza ligjore

Ligji Nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore (në vijim: LPSD), ndër të tjera e rregullon edhe çështjen posedimit. Neni 103 i këtij ligji ka paraparë së *“Personi i cili e ushtron pushtet faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë”*. Tutje neni 104 i LPSD-së përcakton së *“Posedimi në një send fitohet me krijimin e pushteti faktik mbi sendin. Marrëveshja e poseduesit të mëparshëm dhe e fituesit të posedimit është e mjaftueshme për fitimin e posedimit, nëse fituesi është në gjendje që të ushtrrojë pushtetin mbi sendin në momentin e marrëveshjes”*. Në nenin 110 të LPSD-së theksohet së *“Personi i cili e posedon një send që është pronë e tij, është posedues pronësor”*. Ndërsa në nenin 107 par. 1 të LPSD-së është paraparë së *“Posedimi shuhet kur poseduesi heq dorë nga pushteti faktik mbi sendin ose në ndonjë mënyrë e humb pushtetin faktik”*. Neni 113 par.1, 2 dhe 3 i LPSD-së ka paraparë së *“Nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës, i cili në raport me poseduesin është në posedim me të meta”*.

Nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore. Kërkesa kundër ndërhyrjes në posedim është e përjashtuar në qoftë se poseduesi e ka posedimin me të meta në raport me penguesin ose të drejtën e paraardhësit të penguesit”. Ndërsa në nenin 480 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore është paraparë së *“Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit. Përjashtohet mundësia që në kontestet për shkak të pengimit të posedimit të parashtrohet kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me anë të veprimeve me të cilat është bërë pengimi i posedimit”*.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Gjykata në mbështetje të dispozitave të sipërcituara dhe në bazë të nenit 480 të LPK-së, është kufizuar vetëm në konstatimin dhe provimin e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit, pa u lëshuar fare në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën e posedimit, bazën

juridike të posedimit, ndërgjegjshmërinë apo pandërgjegjshmërinë e posedimit. Mirëpo gjykata vë në dukje se për rastin konkret për të ekzistuar akti i pengim posedimit duhet në mënyrë kumulative të përmbushen dy kushte ligjore dhe atë duhet që paditësi të ketë posedimin e fundit faktik, respektivisht të jetë posedues dhe kushti tjetër është që personi i caktuar i cili në mënyrë të kundërligjshme e ka kryer aktin e pengim posedimit, me ç' rast nga të gjithë provat e administruara në këtë kontest, rezulton se nuk janë përmbushur këto dy kushte kumulative, e në veçanti fare nuk bëhet fjalë për kushtin e parë të posedimit të fundit faktik. Bazuar në provat e paraqitura të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe pas daljes në vend më datë 04.05.2023, gjykata ka konstatuar se në pjesën e jashtme të objektit është vendosur nga ana e rrugës, për më tepër nga dëgjimi i dëshmitarëve Š.M. dhe Z.S. është vërtetuar se këtu ndërgjyqësit kanë në posedim të përbashkët objektin në atë mënyrë që padituri shfrytëzon përdhësen ndërsa paditësi katin e parë, gjykata nuk ka mund të identifikoi ndonjë indikacion të qëndrueshëm që të justifikonte pretendimin e paditësit se këtu i padituri kishte vepruar në mënyrë që do të pengonte posedimin e palës kundërshtare, pasi instalimi i kutisë – ormanit të njehsorit elektrik në pjesën e jashtme të objektit-shtallës nuk ka pasur ndonjë ndikim negativ në përdorimin e objektit - shtallës nga ana e paditësit. Kështu, gjykata arriti në përfundimin se veprimet e të paditurit me rastin e vendosjes të kutisë - ormanit të njehsorit elektrik nuk mund të konsiderohen si pengim i posedimit për shkak të mungesës së veprimit të tij në pengimin e posedimit të palës tjetër-paditësit pasi që ormani elektrik është vendosur në mur në pjesën e jashtme të tij nga rruga me qëllim që Keds të ketë qasje në leximin e njehsorit dhe si tillë nuk ka privuar paditësin nga posedimi i katit të parë.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka konstatuar se të njëjtat vlerësoi se janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike-kontestimore.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit këtij aktvendimi që pala paditësi ti bartë shpenzimet e procedurës, si palë gjyq humbëse, mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452.1 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të përgjigjes në padi në shumën prej 80.00 euro dhe për 6 (gjashtë) seanca, për secilën seancë nga 135.00 euro (6 x 135.00 euro = 810.00 euro), përkatësisht shumën e përgjithshme prej 890.00 euro.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 142.3 në lidhje me nenin 480 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.3241/2023, datë 19.04.2024

Gjyqtari,

Taulant Rexhëbeqaj

Numri i lëndës: 2021:223295
Datë: 19.04.2024
Numri i dokumentit: 05597859

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.